

Merre ardhmërinë tënde në duart tua!

Të gjitha informatat lidhur me zgjedhjet parlamentare në Bavari 2023

A je ngopur me ide të vjetra dhe egomaniak? Ne jemi ngopur.

Egoshou dhe populizmi nuk e qojnë Bavarinë përpara. A dëshiron që s'bashku me ne të vësh diçka në lëvizje?

Atëherë bashkohu me ne dhe bëhu pjesë e ekipit #TeamBayern:

- Ne veprojmë, në vend që të ankohemi
- Ne i zgjedhim problemet, në vend se ti shtyejmë për më vonë
- Ne i vejmë gjërat në lëvizje, deri sa CSU luan me ardhmërinë tonë



Zgjedh energjinë më të lirë elektrike!

Qëmoti ke menduar që të përfitosh nga energjia e gjelbërt - po të mos ishte CSU e cila me vite bllokoi një gjë të tillë. Me ne do të zhvillohet dhe do të marrë hov energjia me erë.

Çdo turbinë e re me erë e bënë më të lirë energjinë tënde elektrike. Përfiton rrymë të pastër dhe të sigurt. Vendi i yt i punës do të jetë i sigurt nga kriza, sepse edhe ekonomia e jonë është e sigurt me energji të gjelbërt nga Bavaria.



Zgjedh klimën në vend të krizës!

Ne jetojmë në Bavari e cila është e mrekullueshme - mirëpo kush na mbron ne nga ngrohtësirat, thatësitat dhe kohërat e liga?

Qeveria e tashme shtetërore e Bavarisë rrinë dhe bënë sehir.

Ne angazhohemi seriozisht për mbrojtjen klimatike: Atdheu ynë Bavaria, me fushat e gjelbërta dhe pyjet e dendur do të mbesin të ruajtura dhe të paprekshme. Bavaria e jote do të mbetet ekonomikisht e fortë, sepse me ne do të bëhet një vend udhëheqës në botë për mbrojtjen e klimës. Ti edhe më tutje do të jesh në gjendje që të shijosh verën në liqen dhe borën dimërore.



Zgjedh ardhmërinë për fëmijët!

Më kryesorja është që fëmijve tanë të ju mundësojmë një fillim të mbarë në jetë:

Për një vend të mirë dhe të sigurt në kopsht për secilin fëmij.

Për një shujtë të shëndetshme dhe falas në secilën shkollë.

Për të gjithë fëmijët transporti (bartja) do të jetë falas (Busat dhe trenat do të qarkullojnë më shpesh)



Zgjedh pagë (pagesë)të barabart

Shumë të punësuar fitojn më pak se sa meritojnë. Ti poashtu?

Ne do të përkujdesemi për një drejtësi më të madhe ekonomike:

Si grua do të marrësh më në fund pagë të njëjtë sikurse kolegët tu meshkuj.

Nëse punon në sektorin e shëndetësisë, në edukimin e fëmijve apo në një sektor tjetër të përkujdesjes? Ne ty të sigurojmë një pagesë që është fer dhe e merituar.

E pra tash përpara. Për këtë arsye na duhen të gjobërit e fortë në parlamentin bavarez. Me votën tënde i përvishemi punës. Me 8 tetor secila votë për të gjelbërit!

Dëshiron që të na mbështesësh? Atëherë eja në ekipin tonë Team Bayern!

[Anëtarsohu](#) ose na mbështet me një [donacion](#) apo dhuro ndonjë [plakat](#).

Vetëm të bashkuar do të arrijmë që Bavaria edhe më tutje në të ardhmen do të mund të furnizohet me energji elektrike të përballushme financiarisht (të lirë).

Vetëm të bashkuar do të mundemi të kemi një jetë të mirë dhe të denjë për të gjithë njerzit që jetojnë në Bavari. Të faleminderit për ndihmën tënde!

Këtu mund të gjesh [programin](#) zgjedhor për një jetë më të mirë në Bavari.

Nëse të nevojiten më shumë informata në më shumë gjuhë në lidhje me programin tonë zgjedhor, të lutem lajmërohu tek ne në: programm@gruene-bayern.de

Ju ndihmojm me kënaqësi

Ky version i programit zgjedhor është përkthyer nga anëtarët e partisë në baza vullnetare. Ky tekst i përkthyer nuk paraqet programin zyrtar zgjedhor të Bündnis 90/Die Grünen në Bavari dhe nuk i nënshtrohet saktësisë dhe përpunueshmërisë.